



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 54/2026

Datë: 15/05/2026

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 mars 2019), bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-68, pjesa IV, neni 81, si dhe neni 70 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, mbi aktivitetin e menaxhimit të Kontratës, Sekretari i Përgjithshme i Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Atdhe Berisha, Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative, caktohet mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe për mbikëqyrjen e realizuar të obligimeve dhe detyrave kontraktuese të specifikuara në kontratën me titull „**Furnizim me inventar për Ministrinë e Drejtësisë dhe njësitë e saj**, me numër të kontratës: 215-26-1066-5-5-8/C160.
2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës nga pika 1 e këtij vendimi ka për detyrë që:
 - 2.1. Mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të kontratës;
 - 2.2. Administrimin e plote të kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual në kontratë; dhe
 - 2.3. Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performances së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxheret e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ridvan Hoti

Sekretari i Përgjithshëm

Vendimi i'u dërgohet:

- Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës z. Berisha;
- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit të Prokurimit; dhe
- Arkivit.